REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 141/16
Datë/Datum 20.05.2016
PRISHTINË - PRIŠTINA

Organi Shqyrtues i Prokurimit

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **220-16-002-2-1-1**

Sa i përket tenderit për: **Sigurimi fizik i objekteve të Spitalit Regjional të Prizrenit dhe Vushtrrisë**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

"ROSA-SECURITY" SH.P.K
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

RR.EDIT DURHAM NR.213/B, PRIZREN
(Adresa)

PRIZREN
(Vendi)

20 000
(Kodi postar)

045 625 000
(Numri Telefonit)

038 739 913
(Numri i Faks-it)

AYLA DAMKA
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

office@rosa-security.com
(Adresa elektronike)

17.05.2016
(Data e parashtrimit të kërkesës)

KOMPANIA E SIGURIMIT FIZIK ROSA

Ayla Damka
(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë / KRPP - 14.03.2016
Dorëzimi i Ofertave / QKUK – 04.04.2016 ora 12:00
Hapja e Ofertave / QKUK – 04.04.2016 ora 12:30
Njoftimi për dhënie të kontratës / KRPP - 06.05.2016
Kriteri për dhënie të kontratës: Çmimi më i ulët

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [X] **Jo** [ ]

Gjatë procesit të hapjes së ofertave, kemi bërë vërejtje ndaj një OE "Panther Security" që formularin e çmimit nuk e ka pasur të plotësuar dhe çmimin total në listën e çmimit nuk e ka pasur të plotësuar.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] **Jo** [ ]

Po jemi njoftuar me shkrim, për tenderuesin e pasuksesshëm.

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] Jo [ ]

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A te LPP-së.

Kemi dorëzuar kërkesën për rishqyrtim tek Autoriteti Kontraktues me datën 12.05.2016 dhe kemi pranuar përgjigje me datën 13.05.2016.

Autoriteti Kontraktues ndaj kërkesës për rishqyrtim ka marrë vendim për refuzimin e kërkesës si e pa-bazuar pasi që kanë kaluar afatet ligjore.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Kërkesa jonë për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin mbi dhënie të kontratës.

*** Supozohet se Autoriteti Kontraktues ka shkelur Nenin 7 të UOPP dhe LPP-së,**

*** Supozohet se Autoriteti Kontraktues ka shkelur Nenin 28 të LPP-së,**

*** Supozohet se Autoriteti Kontraktues ka shkelur Nenin 31 të LPP-së,**

*** Supozohet se Autoriteti Kontraktues ka shkelur Nenin 52 të LPP-së,**

*** Supozohet se Autoriteti Kontraktues ka shkelur Nenin 57 të LPP-së,**

*** Supozohet se Autoriteti Kontraktues ka shkelur Nenin 59 të LPP-së,**

*** Supozohet se Autoriteti Kontraktues ka shkelur Nenin 60 të LPP-së,**

*** Supozohet se Autoriteti Kontraktues ka shkelur Nenin 61 të LPP-së,**

*** Supozohet se Autoriteti Kontraktues ka shkelur Nenin 69 të LPP-së.**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

- Supozohet se Autoriteti Kontraktues ka shkelur Nenin 7 të LPP-së:

Par.1 i Nenit 7 të LPP-së
Autoriteti kontraktues nuk i ka trajtuar operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe ka vepruar në mënyrë diskriminuese dhe ska qenë transparent.

Gjatë shqyrtimit të dosjeve të përgatitura nga ana e **SHSKUK** për sigurim fizik dhe pastrim të objekteve, kemi vërejtur se ky Autoritet Kontraktues ka vendosur të njejtat kritere lidhur me çështjen e pagave, në dosjen për pastrim të objekteve Autoriteti Kontraktues ka rekomanduar për dhënie të kontratës ofertat të cilat i kanë rrespektuar kriterin e pagave, por në dosjen e tenderit për sigurim fizik ka rekomanduar ofertën e cila nuk ka rrespektuar këtë kriter.

Par.2 i Nenit 7 të UOPP-së
Deklarata e nevojave dhe përcaktimi i disponueshmërisë së fondeve
ZKF do të siguroj që fondet janë në disponueshmëri për prokurimin në fjalë.

7.3 Nëse AK është autoritet publik ose organizatë buxhetore ZKF do të siguroj që:

a. Fondet janë alokuar; ose
b. Fonde të mjaftueshme do të alokohen në vitin fiskal në fjalë. Kjo dispozitë do të përfshihet në kontratën publike.

Autoriteti Kontraktues ka dhënë tenderin ofertuesit që ka kaluar vlerën e parashikuar të kontratës.

Par.3 i Nenit 7 të LPP-së
Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledh sasitë ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.

- Supozohet se Autoriteti Kontraktues ka shkelur Nenin 28 të LPP-së:

Par.2 i Nenit 28 të LPP-së
Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

Me çrast Autoriteti Kontraktues ka favorizuar operator ekonomik pasi që nuk iu është dhënë kontrata Operatorit Ekonomik i cili ka qenë i përgjegjshëm me çmim më të lirë, por ia ka dhënë kontratën Operatorit Ekonomik i cili nuk i ka përmbush kriteret e çmimit sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues në dosjen e tenderit.

*** Supozohet se Autoriteti Kontraktues ka shkelur Nenin 31 të LPP-së**

Par.2 i Nenit 31 të LPP-së
Autoritetet Kontraktuese mund të referohen në kushtet e performancës së kontratës në veçanti atyre të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjen e punëtorëve dhe kushteve të punës të cilat janë në fuqi me ligj apo rregullore në Kosovë, me kusht që këto kushte të përfshihen në shpalljen e kontratës dhe në specifikimet teknike.

Autoriteti Kontraktues tek Specifikimet Teknike të Detyrueshme në FDT ka kërkuar nga të gjithë OE-të si kriter që të rrespektojnë kontratën kolektive dhe që pagesa bruto për secilin punëtorë të caktuar në secilën LOT tu jipet në shumë prej 302.00 €, por SHSKUK nuk ka vepruar sipas Nenit 3 të Udhëzimit Administrativ Nr.04/2015 të KRPP-së, pasi që pagës bruto 302.00 € nuk ia kanë shtuar kontributin e punëdhënësit prej 5% OE-të e rekomanduar për dhënie të kontratës, por OE-të e rekomanduar për kontratë kanë bërë zbritjen e kontributit që duhet ta shtojnë nga paga bruto e punëtorit, kurse në FDT Autoriteti Kontraktues kjartë ka shënuar që pagës bruto 302.00 € ti shtohet edhe pagesa e kontributit nga ana e punëdhënësit, gjë të cilën OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka bërë.

*** Supozohet se Autoriteti Kontraktues ka shkelur Nenin 52 të LPP-së**

Par.3 i Nenit 52 të LPP-së
Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim. Autoriteti kontraktues mund të përdorë vetëm kritere që janë relevante në mënyrë direkte me lëndën e kontratës. Kritere të tilla janë por nuk kufizohen në lidhje me: cilësinë, çmimin, meritat teknike, estetike, dhe karakteristikat funksionale, karakteristikat e mjedisit, shpenzimet rrjedhëse, efektiviteti i kostos, shërbimet e pas-shitjes dhe asistenca teknike.

Me çrast Autoriteti Kontraktues nuk i ka përdor kriteret e tij për vlerësim të ofertave, pasi që ka rekomanduar për dhënie të kontratës për LOT 1 *dhe* LOT 2 kompanisë e cila nuk i plotësonë kërkesat e tenderit tek Specifikimet Teknike të Detyrueshme.

*** Supozohet se Autoriteti Kontraktues ka shkelur Nenin 57 të LPP-së**

Par.4 i Nenit 52 të LPP-së
Nëse autoriteti kontraktues vendos kusht për siguri të tenderit, autoriteti kontraktues duhet të përcaktojë në dosjen e tenderit:
4.2. shuma e saktë e sigurimit të tenderit dhe periudha e nevojshme e vlefshmërisë për sigurimin e tenderit;
4.3. afati kohor për pranimin e sigurimit të tenderit, që është i njëjtë me atë për pranimin e tenderëve.

Gjatë qasjes në dokumente zyrtare në analizimin e ofertës së OE të rekomanduar për kontratë LOT 1 dhe LOT 2 "Rojet e Nderit" SH.P.K kemi vërejtur që ky OE ka ofruar sigurimin e tenderit nga data e hapjes së ofertave nga 04.04.2016 deri më 02.08.2016 ora 09:44:34. Me çrast kemi të bëjmë me 119 ditë të plota të sigurimit pasi që dita e 120-të nuk është e plotë dhe nuk mund të konsiderohet si e till.

Dmth dita e fundit ka mangu: 14:15:26 (katërmbëdhjetë orë e pesëmbëdhjetë minuta e njëzetetë e gjashtë sekonda), për LOT - 1.

Poasthu pas analizimit të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë LOT 2 "Rojet e Nderit" SH.P.K kemi vërejtur se i njejti ka ofruar sigurimin e tenderit nga data e hapjes së ofertave nga 04.04.2016 deri më 02.08.2016 ora 09:47:03, me çrast kemi të bëjmë poashtu me 119 ditë të plota të sigurimit pasi që dita e 120-të nuk është e plotë dhe nuk mund të konsiderohet si e till.

Dmth dita e fundit ka mangu: 14:12:57 (katërmbëdhjetë orë e pesëdhjetë e gjashtë minuta e tridhjetë e katër sekonda), për LOT - 2.

Andaj OE duhet të refuzohet si i papërgjegjshëm pasi që nuk e ka përmbush kërkesën e AK për sigurimin e tenderit, sepse periudha e nevojshme e vlefshmërisë për sigurimin e tenderit, nuk është përmbushur.

*** Supozohet se Autoriteti Kontraktues ka shkelur Nenin 59 të LPP-së**

Par.4 i Nenit 59 të LPP-së
Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit...

Pra Autoriteti Kontraktues SHSKUK ka vlerësuar ofertën e OE "Rojet e Nderit" SH.P.K si të përgjegjshëm por e cila nuk plotëson kriteret e parashtruara në dosjen e tenderit, pasi që nuk e ka përmbushur kërkesën e pagave.

Pra OE "Rojet e Nderit" SH.P.K ka ofruar Deklaratën Nën Betim te paragrafi i parë ku thuhet:

Unë, i poshtë nënshkruari, duke pënshkruari, duke përfaqësuar: [operatorin ekonomik që paraqitet] | **këtu është dashur të plotësohet emri i OE-së e ky gabim nuk është dashur të anashkalohet**.

*** Supozohet se Autoriteti Kontraktues ka shkelur Nenin 60 të LPP-së**

Par.1 i Nenit 60 të LPP-së
Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose:
1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

Autoriteti Kontraktues nuk e ka rrespektuar kritertin për tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

*** Supozohet se Autoriteti Kontraktues ka shkelur Nenin 61 të LPP-së**

Tek Pyetjet e Shpeshta në web-faqen e KRPP-së, është dhënë kjo pyetje dhe përgjigje:

29. Cila është procedura që duhet ndjekur në rast se Operatori Ekonomik vendos çmimin "0.00" euro në një nga artikujt/pozicionet (elementet përbërëse të tenderit)?

KRPP Një procedurë e tillë nuk është e rregulluar me dispozita të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik dhe as me legjislacionin dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me këtë ligj, megjithatë autoritetet kontraktuese duhet të veprojnë si në vijim:

Nëse Operatori Ekonomik nuk plotëson një nga pozicionet në Listën e Përshkrimit të

Çmimeve, tenderi duhet të refuzohet, pasi që tenderi gjithmonë duhet të jetë në përputhje me qëllimin e plotë të kontratës.

Nëse Operatori Ekonomik ofron çmimin "0.00" në një nga pozicionet, tenderi duhet të refuzohet ngase në "Përshkrimin e çmimeve" kërkohet të vendoset çmimi në vlerë të caktuar për secilin artkiull/pozicion të kërkuar në specifikimin teknik.

Nëse Operatori Ekonomik plotëson në një nga pozicionet si: "gratis", tenderi duhet të refuzohet pasi që dhuratat nuk janë të pranueshme.

Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Nenin 1 tek Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, pasi që tek Pjesa II – Lista e Çmimeve tek LOT -1 Operatori i Rekomanduar për kontratë tek rreshti nr.2 i tabelës per staf menaxhues ka dhënë çmimin për njësi 0.001 € e cila është në kundërshtim edhe me rregullat financiare edhe me kërkesat në dosjen e tenderit për pagën e kërkuar prej 302.00 €.

OE i rekomanduar për dhënie të kontratës me çmimin jo-normalisht të ulët çmim për njësi 0.001 € për 36 muaj 3 menaxherëve nuk mundet me 19.01€ tu jep paga në shumë prej 302.00 €.

Poashtu OE i rekomanduar për kontratë "Rojet e Nderit" SH.P.K ka vendosur **Deklaratat Tatimore të ATK-së** në dosjen e tenderit (ofertën e tij) të përgatitur në sistemin elektronik EDI të cilat përgatiten nga kontabilisti i kompanisë por të cilat nuk janë të vulosura nga ana e ATK-së që dëshmon se janë deklaruar në sistemin e ATK-së, dhe Autoriteti Kontraktues i ka pranuar si valide.

Propozojmë që lënda të kthehet në Ri-vlerësim.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

- Neve si Operator Ekonomik na kërcënohet të na shkaktojnë dëme materiale në vlerë të madhe.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*